



Lidhja e kimistëve dhe teknologëve të Maqedonisë

Gara nga kimia për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme

SHIFRA:

(e vendos komisioni pas përfundimit të testimit këtu dhe në zarf)

PËR KOMISIONIN

Pikët e përgjithshme: _____

Kontrolloi (Emri Mbiemri): _____

RREGULLA PËR GARA REGJIONALE NGA KIMIA 2019

- 1) Gara fillon në **ora 10** dhe **zgjat 60 minuta**. Testet e dorëzuara pas kohës së paraparë nuk do të merren parasysh për kontrollim.
- 2) Testet janë të kapur së bashku me zarfet. Në çdonjërin zarf ka fletë në të cilën nxënësi i plotëson të dhënat e kërkuara: emri dhe mbiemri, shkolla, mentori dhe kështu me rradhë, ndërsa më pas e mbyll (e ngjit) zarfin.
- 3) **Nxënësi nuk guxon të vendos asnjë shenjë në test ose zarf.** Shifrën e testit e vendos komisioni ndër dhe mbi zarfin pas mbarimit të garës. Nëse vërehet ndonjë shenjë në test ose zarf, nxënësi do të diskualifikohet.
- 4) Garuesit janë të detyruar të mbajnë me vete stilograf kimik të kaltër. Testet zgjedhen duke përdorur stilograf kimik. **Nuk është e lejuar të punohet me laps.**
- 5) **Telefonat celular** duhet të lihen në katedër në fillim të garës dhe të mirren pas mbarimit të saj.
- 6) Për zgjidhje të testeve mund të përdoret kalkulator.
- 7) Është e ndaluar çfarëdolloj bisede në mes garuesve dhe përdorimi i teksteve shkollore, librave, fletoreve, letrave, sistemit periodik dhe ngjashëm. Të gjitha të dhënat e nevojshme janë të dhëna në test.
- 8) Pikët maksimale që mund të fitohen janë **50**.
- 9) Për përgjigje të saktë fitohen 2 pikë, ndërsa nëse përgjigja ngel e papërgjigjur ose gabimisht e përgjigjur (shlyerja e përgjigjeve ose rrethimi i më tepër përgjigjeve) nuk përfitohen pikë.
- 10) Nëse garuesi dëshiron të parashtrij pyetje, e thëret mësuesin përgjegjës (testatorin) në klasë, i cili e thëret koordinatoren nëpërmjet telefonit celular. Koordinatori, në prani të edhe një mësuesi- mentori, vendos se a duhet t'i përgjigjet pyetjes së nxënësit. Pyetja duhet patjetër të parashtrihet heshtur, shkurt dhe qartë. Nëse që të dy mësuesit vendosin se pyetja meriton të përgjigje, koordinatori me zë e përsërit pyetjen dhe jep përgjigje të cilën duhet ta ndëgjojnë të gjithë nxënësit në klasë. Në të kundërtën, përsëri zëshëm, përgjigjet kështu për shembull: "Ajo nuk është e rëndësishme për garën".
- 11) Garuesi i cili nuk do t'u përmbahet ndonjëres (ose më tepër) prej rregullave/sugjerimeve, do të përjashtohet prej garës.



Përgjigju duke e rrethuar shkronjën para njërës nga opsionet e dhëna. Çdo përgjigje e saktë sjell 2 pikë. Pyetja e papërgjigjur ose e gabuar do të vlerësohet me 0 pikë. Të shkruarit me laps, rrethimi i dy ose më tepër përgjigjeve ose shlyerja e përgjigjes do të vlerësohet si përgjigje e gabuar.

I. TEST ME MË TEPËR PËRGJIGJE TË DHËNA PREJ TË CILAVE VETËM NJË ËSHTË E SAKTË
(Përgjigjet me rrethim të vetëm një përgjigjeje të dhënë nën A, B, C ose D)

- Çka **NUK ËSHTË** e saktë?
 - Gazrat mund të rrjedhin.
 - Gazrat mund të përhapen pakufi.
 - Nëse vendosen në enë të njëjtë, gazrat difundojnë në mes tyre praktikisht menjëherë.
 - Që lëngjet të kalojnë në gjendje agregate të gaztë duhet të nxehen në temperaturë të lartë.
- Në bazë të të dhënave në tabelë, në intervalin e temperaturës prej -10°C deri 10°C , në gjendje agregate të lëngët është/janë:

Substanca	$T_{Sh} / ^{\circ}\text{C}$	$T_v / ^{\circ}\text{C}$
Brom	-7	59
Klor	-101	-34
Etanol	-117	78
Merkur	-39	357

 - Vetëm etanoli.
 - Vetëm merkuri.
 - Etanoli dhe merkuri.
 - Etanoli dhe bromi.
- Vesna ka dashur të bëj hulumtim për t'u përgjigjur në pyetjen: Cili material është më i mirë për përpunimin e ombrellave?. Por, ajo ka dashur ndryshe ta parashtrij pyetjen. Cila pyetje që duhet ta parashtrij është më e mira për këtë hulumtim?
 - Cili material është më i rëndë dhe e lëshon ujin?
 - Cili material është më i lehtë dhe i papërshkueshëm nga uji?
 - Cili material është më laraman?
 - Cili material është më i lehtë dhe më laraman?
- Andrej ka pasur një thes me miell dhe një thes me pupla. Ai ka dashur të hulumtoj cili material është më i butë. Çka duhet të bëj ai?
 - T'i prek materialet në të dy thasët dhe të tregoj cili është më i butë.
 - Të lus dy shokë t'i prekin materialet në të dy thasët dhe të tregojnë cili është më i butë.
 - Të lus dhjetë shokë t'i prekin materialet në të dy thasët dhe të tregojnë cili është më i butë.
 - Të lus dhjetë shokë t'i shikojnë materialet në të dy thasët dhe të tregojnë cili është më i butë.
- Cila prej listave të mëposhtme përmban vetëm metale?
 - Helium, karbon, ar.
 - Natrium, krom, bakër.
 - Jod, hekur, nikël.
 - Fosfor, azot, oksigjen.
- Çka është e saktë?
 - Metalet kanë temperaturë të ulët të shkrirjes.
 - Metalet janë përçues të dobët të nxehtësisë.
 - Jometalet e forta janë të shkëlqyeshme.
 - Jometalet e forta janë të brishta.
- Cila nga të paraqiturat përçon elektricitet?
 - Grafit për laps.
 - Letra e aluminit.
 - Tel i çeliktë
 - Gjitha të lartëpërmendurat.
- Shenja kimike F_2 tregon:
 - Një atom fluor.
 - Një molekulë fluor.
 - Dy molekula fluor.
 - Një njësi formulare fluor.
- Rretho pohimin e gabuar. Simboli kimik Cu mund të simbolizon:
 - Element të bakrit
 - Substancë të thjeshtë të bakrit .
 - Një molekulë të bakrit.
 - Një atom të bakrit.

10. Cilat prej formulave të mëposhtme janë formula të substancave elementare, ndërsa cilat të komponimeve?

1. O₂
2. H₂SO₄
3. O₃
4. NO

- A. Të substancave elementare: 1 dhe 3; të komponimeve: 2 dhe 4.
- B. Të substancave elementare: 1; të komponimeve: 2, 3 dhe 4.
- C. Të substancave elementare: 2 dhe 4; të komponimeve: 1 dhe 3.
- D. Të substancave elementare: 2, 3 dhe 4; të komponimeve: 1.


11. Cila nga të paraqiturat **NUK** paraqet përzierje?

- A. Kafja.
- B. Qumështi
- C. Etanoli.
- D. Uthulla.

12. Ajri është:


- A. Substancë e thjeshtë.
- B. Substancë elementare.
- C. Komponim.
- D. Përzierje.

13. Cili nga diagramet, X, Y dhe Z paraqet përzierje të substancave elementare?



- A. Vetëm X.
- B. Vetëm Z.
- C. X dhe Y.
- D. X dhe Z.

14. Cili barazim tekstual përputhet me reaksionin e paraqitur me diagramin korpuskular (diagram me thërrmija)?



- A. Sulfur + oksigjen → dioksid sulfuri

- B. Sulfur + oksigjen → trioksid sulfuri
- C. Hidrogjen + oksigjen → ujë
- D. Karbon + oksigjen → monoksid karboni

15. Cili element i metaleve e ngjyros flakën në të verdhë?

- A. Kaliumi.
- B. Litiumi.
- C. Kalciumi.
- D. Natriumi.

16. Emri i komponimit formula e të cilit është Li₃N është:

- A. Mononitrur trilitiumi.
- B. Nitrur litiumi.
- C. Azotat litiumi.
- D. Nitrur litiumi.

17. Janë dhënë dy pohime:

- i. Gjatë kontaktit të gazit të klorit të verdhë në të gjelbër me metalin e natriumit të argjend në të bardhë fitohen kristale të bardha të klorur natriumit (kripës së kuzhinës).
- ii. Me ndihmën e magnetit mund të ndahet tallash hekuri me ngjyrë hiri të mbyllur nga rëra e bardhë.

Çfarë ndryshimi është përshkruar me që të dy pohimet:

- | | i. | ii. |
|----|-------|-------|
| A. | fizik | fizik |
| B. | fizik | kimik |
| C. | kimik | fizik |
| D. | kimik | kimik |

18. Cila prej substancave vijuese sjell ndryshim kimik nëse shtohet në ujë?

- A. Vaji për ushqim.
- B. Biberi i zi.
- C. Uthulla.
- D. Tabletë shkumëzuese.

19. Sipas ligjit të ruajtjes së masës, në reaksion kimik:

- A. Materja as nuk asgjësohet, as nuk mund ta ndryshoj formën.
- B. Materja mund të asgjësohet, por nuk mund ta ndryshoj formën.
- C. Materja mund të kalojë prej një lloji në lloj tjetër.
- D. Nëse formohet fundërrinë, masa në fund të reaksionit është më e madhe sesa masa në fillim.

20. Cila prej formulava të mëposhtme është formulë e kripës?

- A. CH_3COOH
- B. Na_2O
- C. $\text{Fe}_2(\text{SO}_4)_3$
- D. $\text{Mg}(\text{OH})_2$


21. Cila substancë duhet të përzihet me hidroksidin e natriumit për t'u formuar hidroksidi i zinkut dhe sulfati i natriumit?

- A. Sulfat zinku.
- B. Zinku.
- C. Acidi sulfurik.
- D. Acidi sulfhidrik.

22. Gjatë reaksionit të acidit sulfurik dhe oksid magnezit fitohet:

- A. Sulfat magnezi, dioksid karboni dhe ujë.
- B. Sulfat magnezi dhe hidrogjen.
- C. Sulfat magnezi dhe ujë.
- D. Sulfat magnezi dhe oksigjen.

23. Simboli në foto paralajmëron për rrezik nga:



- A. Substancat oksiduese.
- B. Substancat lehtë të ndezshme.
- C. Substancat toksike.
- D. Substancat korrozive.

24. Acidet janë substanca të cilat:

- A. Shkaktojnë djegie.
- B. Përmbajnë elementin e hidrogjenit.
- C. Përmbajnë elementin e oksigjenit.
- D. E ngjyrosin ujin në të kuqe.

25. Cila prej substancave të dhëna ka vlerë më të ulët të pH?

- A. Qumështi.
- B. Soda bikarbonate.
- C. Limonada.
- D. Amoniaku.

1																		18	
1	1.00794 1 H																	4.00260 2 He	
Group		Group																Group	
2	6.941 3 Li	9.01218 4 Be											10.81 5 B	12.011 6 C	14.0067 7 N	15.9994 8 O	18.9984 9 F	20.180 10 Ne	
3	22.98977 11 Na	24.305 12 Mg											26.98154 13 Al	28.0865 14 Si	30.97376 15 P	32.065 16 S	35.453 17 Cl	39.948 18 Ar	
4	39.0983 19 K	40.078 20 Ca	44.9559 21 Sc	47.88 22 Ti	50.9415 23 V	51.996 24 Cr	54.9380 25 Mn	55.945 26 Fe	58.9332 27 Co	58.9332 28 Ni	63.546 29 Cu	65.38 30 Zn	68.723 31 Ga	72.64 32 Ge	74.9216 33 As	78.96 34 Se	79.904 35 Br	83.798 36 Kr	
5	85.4678 37 Rb	87.62 38 Sr	88.9058 39 Y	91.224 40 Zr	92.9064 41 Nb	95.94 42 Mo	98 43 Tc	101.07 44 Ru	102.906 45 Rh	106.42 46 Pd	107.868 47 Ag	112.41 48 Cd	114.818 49 In	118.71 50 Sn	121.760 51 Sb	127.60 52 Te	126.904 53 I	131.29 54 Xe	
6	132.905 55 Cs	137.33 56 Ba	138.9055 57 La	178.49 72 Hf	180.947 73 Ta	180.94 74 W	186.207 75 Re	190.23 76 Os	192.225 77 Ir	195.08 78 Pt	196.967 79 Au	200.59 80 Hg	204.38 81 Tl	207.2 82 Pb	208.980 83 Bi	208.980 84 Po	208.980 85 At	222 86 Rn	
7	0.00018 87 Fr	0.00018 88 Ra	0.00018 89 Ac	0.00018 104 Rf	0.00018 105 Db	0.00018 106 Sg	0.00018 107 Bh	0.00018 108 Hs	0.00018 109 Mt	0.00018 110 Ds	0.00018 111 Rg	0.00018 112 Cn	0.00018 113 Uut	0.00018 114 Uuq	0.00018 115 Uup	0.00018 116 Uuh	0.00018 117 Uus	0.00018 118 Uuo	